



Shkruan: Ismail SYLA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

GLAUK KONJUFCA, NJË JAVË PARA MBAJTJES SË SEANCËS KONSTITUIVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, KA TAKUAR PËRFAQËSUESIT E PARTIVE POLITIKE

KONJUFCA: NUK I ARRITËM 500 MIJË VOTA. TASH ËSHTË SKENARI B, KOALICIONET

FAQE 4-5



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, njëherësh nënkryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, tha se nuk beson se është i mundur formimi i

qeverisë së re pa përfshirjen në koalicionin qeverisës të partive opozitare. Konjufca tha se Vetëvendosja ka pasur synim që në zgjedhjet e 9 shkurtit të fitonte

500 mijë vota, në mënyrë që të drejtonte e vetme qeverinë e ardhshme. Por, sipas tij, rezultati zgjedhor ka treguar se një gjë e tillë nuk është e mundshme

AKTUALE



**BISEDIMET E REJA PËR UKRAINËN
THEKSOJNË PËRÇARJET
NË MES TË SHBA-SË DHE EVROPËS** F. 2

**KALLASI: VITI 2030, OBJEKTIV
REALIST PËR ANËTARËSIMIN
E SHQIPËRISË NË BE** F. 5

**DITA NDËRKOMBËTARE E ROMËVE,
OSMANI VLERËSON LART
KONTRIBUTIN E KOMUNITETIT ROM** F. 7

EKONOMI



**AUV-I: MISHI I BARDHË
NË TREGUN E KOSOVËS
ËSHTË I SIGURT** F. 8

**QEVERIA VENDOS MARZHË FITIMI
PËR NAFTËTARËT** F. 8

SPORT



**SOT GJYSMËFINALJA E PARË DRITA
- PRISHTINA, NESËR PËRBALLEN
LLAPI - DRENICA** F. 10

**SHUMICA E
DEPUTETËVE
NGA PAKICAT
THONË SE
S'KANË PRESION
NGA SERBIA PËR
MOSFORMIM TË
QEVERISË** F. 6



**KURTI KËRKON AVANCIMIN
E KËRKESËS SË KOSOVËS
PËR ANËTARËSIM NË BE** F. 7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bisedimet e reja për Ukrainën theksojnë përçarjet në mes të ShBA-së dhe Evropës

Një javë tjetër e mbushur me planifikime ushtarake dhe diplomaci do t'i nxjerrë sërish në pah përçarjet në mes të Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të saj evropianë sa i përket politikës ndaj Ukrainës, me dy takime kyçe të njëpasnjëshme në selinë e NATO-s në Bruksel



KIEV, 8 PRILL - Një javë tjetër e mbushur me planifikime ushtarake dhe diplomaci do t'i nxjerrë sërish në pah përçarjet në mes të Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të saj evropianë sa i përket politikës ndaj Ukrainës, me dy takime kyçe të njëpasnjëshme në selinë e NATO-s në Bruksel. ShBA-ja do të mungojë në takimin e parë dhe pritet të mos ketë ndonjë rol të rëndësishëm as në të dytin, pasi vendet evropiane synojnë të ecin përpara me planet e tyre. Takimi i parë, më 10 prill, do t'i mbledhë ministrat e Mbrojtjes nga, siç njihet, "koalicioni i vendeve të gatshme për veprim", që përfshin edhe vende jashtë Evropës si Kanadaja dhe Australia. Ky grup prej 30 shtetesh u krijua në fillim të marsit pas një përplasjeje të ashpër mes presidentit amerikan Donald Trump dhe presidentit ukrainas Volodymyr Zelenskyy në Shtëpinë e Bardhë. Një nga objektivat kryesore të këtij koalicioni është formimi i një force ushtarake që do të dislokohej në Ukrainë pas një armëpushimi ose marrëveshjeje paqej.

Por një problem i madh për krijimin e kësaj force është mungesa e mbështetjes nga ShBA-ja. Shumë vende, përfshirë Britaninë, kanë deklaruar se kjo do të ishte e mundur vetëm me një "garanci nga ShBA-ja", që nënkupton mbështetje ajrore, logjistike dhe inteligjencë. Deri më tani nuk ka sinjale të qarta nga ShBA-ja që do ta marrë këtë rol. Ish-komandanti i NATO-s në Evropë, Philip Breedlove, i tha Radios Evropa e Lirë se nuk besonte se ekziston vullneti politik në Uashington për ta bërë këtë, por theksoi se Evropa duhet të ecë përpara me planet e saj gjithsesi. "Nëse z. Putin sheh përtej gardhit një koalicion të madh të të gatshmeve, që përfshin Britaninë, Francën dhe Gjermaninë, ai do të mendohet dy herë", tha ai. Nuk është ende e qartë nëse Gjermania do të marrë pjesë në ndonjë prani ushtarake në Ukrainë, pasi vendi ndodhet në një periudhë tranzicioni politik pas zgjedhjeve të shkurtit dhe është në proces formimi të një qeverie të re. Britania dhe Franca po udhëheqin koalicionin, duke premtuar përkrahje ushtarake

për misionin, dhe do të jenë mikpritës të takimit të 10 prillit. "Unë mendoj se Evropa mund ta bëjë këtë vetë", tha Breedlove. "Ushtria ruse është e rraskapitur. Ajo ka nevojë urgjente për një periudhë paqeje që të riorganizohet dhe të ripajiset. Do të ishte dhurata më e madhe që mund t'ia jepnim Rusisë, po ta lejojmë të rindërtohet", shtoi ai. Deklaratat e tij përputhen me ato të ish-komandantit të ushtrisë amerikane në Evropë, Ben Hodges, i cili muajin e kaluar i tha REL-it se forcat evropiane kishin "gra dhe burra të pajisur mirë" që mund ta përballonin detyrën pa përfshirjen e ShBA-së. Megjithatë, përfshirja e ShBA-së mbetet ende një pikë kyçe në agjendë. "Evropianët duhet ta bindin Trumpin që ta mbështesë këtë ide", tha Jamie Shea, ish-zyrtar i lartë në NATO. "Është e qartë që kjo do të jetë një forcë e

vogël dhe jo në vijën e parë të frontit... Por pyetja e madhe është: a do të dislokohej ndonjëherë kjo forcë nëse nuk ka paqe dhe lufta vazhdon", shtoi ai. Një ditë pas bisedimeve të koalicionit të të gatshmeve, përçarjet transatlantike do të dalin sërish në pah në takimin e Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, i krijuar në vitin 2022 nga ish-sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin. Austin drejtonte këto takime që kishin për synim koordinimin e ndihmës ushtarake për Ukrainën pas agresionit të plotë të Rusisë. Por pasardhësi i tij, Pete Hegseth, sipas të gjitha gjasave, do ta anashkalojë takimin. Një deklaratë e Pentagonit më 4 prill tha se ai do të udhëtojë për në Panama. "Liderët e aleatëve tanë evropianë duhet ta marrin përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e kontinentit", tha Hegseth në shkurt. "Vlerat janë

të rëndësishme, por nuk mund të qëllosh me vlera. Nuk mund të qëllosh me flamuj apo me fjalime të forta. Nuk ka zëvendësim për fuqinë e vërtetë ushtarake", shtoi ai, duke i bërë thirrje Evropës t'i rrisë shpenzimet për mbrojtje. Hegseth i bëri këto komente një ditë pasi mori pjesë, por nuk e drejtoi takimin e fundit të Grupit të Kontaktit. "Mungesa e Hegsethit nënkupton që ShBA-ja nuk ka asnjë paketë të re ndihme për ta shpallur", tha ish-zyrtari i NATO-s, Shea. "ShBA-ja ka të ngjarë që ende po e lidh ndihmën me rezultatin e negociatave për marrëveshjen mbi mineralet me Ukrainën. E konsideroj sekretarin Hegseth mik, por mendoj se është një gabim i madh që ai nuk merr pjesë", tha Breedlove. "Amerika duhet të vazhdojë të tregojë udhëheqje në Evropë", shtoi Breedlove.

Trumpi kërcënon Kinën me tarifa prej 50-përqindësh

UASHINGTON, 8 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, tha se do të vendosë një tarifë shtesë prej 50-përqindësh ndaj mallrave të importuara nga Kina nëse Pekini nuk i tërheq tarifat hakmarrëse kundër Shteteve të Bashkuara. "Gjithashtu, të gjitha bisedimet me Kinën në lidhje me takimet që ata kanë kërkuar me ne do të ndërpriten! Negociatat me vende të tjera, të cilat gjithashtu kanë kërkuar takime, do të fillojnë menjëherë", tha Trumpi në një postim në Truth Social. Javën e kaluar Trumpi vendosi tarifa prej 34-përqindësh ndaj mallrave kineze. Këto tarifa janë pjesë e një vendimi më të gjerë, përmes të cilit ShBA-ja ka vendosur tarifa ndaj shumicës së partnerëve tregtarë. Më 4 prill Pekini iu kundërpërgjigj tarifave të reja amerikane, duke vendosur një tarifë shtesë prej 34-përqindësh ndaj mallrave amerikane, lëvizje që paraqet një përshkallëzim në luftën tregtare mes dy



ekonomive më të mëdha në botë. Ministria e Tregtisë e Kinës tha se do të vendosë më shumë kontrolle mbi eksportet e mineraleve të rralla, të cilat përdoren në produkte të teknologjisë së lartë, si çipat kompjuterikë dhe bateritë e

automjeteve elektrike. Kërcënimi i fundit i Trumpit për tarifat prej 50-përqindësh trazoi edhe më shumë tregjet financiare globale, të cilat kishin rënë vazhdimisht që prej njoftimit të javës së kaluar nga Trumpi. Një tarifë bazë prej 10-përqindësh hyri në fuqi për të

gjitha importet në tregun amerikan të shtunën, dhe tarifat për disa shtete që mund të arrijnë deri në 50 për qind priten të hyjnë në fuqi të mërkurën. Aksionet amerikane ndaluan përkohësisht rënien e tyre pas një raporti që thoshte se Trumpi po shqyrtonte një pauzë 90-ditore

për tarifat, por rënia filloi sërish pasi Shtëpia e Bardhë e cilësoi raportin "lajm të rremë". Investitorët frikësohen se tarifat që Trumpi shpalli javën e kaluar mund të çojnë në rritje çmimesh, ulje të kërkesës dhe, potencialisht, në një recesion global. Elon Musk, njeriu më i pasur në botë dhe një aleat i afërt i Trumpit në përpjekjet për t'i ulur shpenzimet e qeverisë, të shtunën tha se shpreson të shohë tarifa zero midis ShBA-së dhe Evropës. Të hënën ai publikoi në rrjetet sociale një video të ekonomistit Milton Friedman që lavdëronte sistemin tregtar ndërkombëtar. Investitorët dhe liderët politikë janë ende të pasigurt nëse tarifat e Trumpit janë pjesë e një regjimi të ri të përhershëm apo një taktikë negociuese për të marrë lëshime nga vende të tjera. Disa janë të shqetësuar, se një kundërpërgjigje me tarifa nga Evropa rrezikon të sjellë tarifa edhe më të larta për eksportuesit evropianë.

GLAUK KONJUFCA, NJË JAVË PARA MBAJTJES SË SEANCËS KONSTITUIVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, KA TAKUAR PËRFAQËSUESIT E PARTIVE POLITIKE

KONJUFCA: NUK I ARRITËM 500 MIJË VOTA. TASH ËSHTË SKENARI B, KOALICIONET



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, njëherësh nënkryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, tha se nuk beson se është i mundur formimi i qeverisë së re pa përfshirjen në koalicionin qeverisës të partive opozitare. Konjufca tha se Vetëvendosja ka pasur synim që në zgjedhjet e 9 shkurtit të fitonte 500 mijë vota, në mënyrë që të drejtonte e vetme qeverinë e ardhshme. Por, sipas tij, rezultati zgjedhor ka treguar se një gjë e tillë nuk është e mundshme

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 PRILL - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, njëherësh nënkryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, tha se nuk beson se është i mundur formimi i qeverisë së re pa përfshirjen në koalicionin qeverisës të partive opozitare. Konjufca tha se Vetëvendosja ka pasur synim që në zgjedhjet e 9 shkurtit të fitonte 500 mijë vota në mënyrë që të drejtojë e vetme qeverinë e ardhshme. Por, sipas tij, rezultati zgjedhor ka treguar se një gjë e tillë nuk është e mundshme. “E kemi pasur qëllimin [t’i sigurojmë] 500 mijë vota. Nuk i kemi arritur ato. Tash është një skenar tjetër. Është skenari B”, ka deklaruar Konjufca pas një takimi me përfaqësuesit e partive politike, një javë para mbajtjes së seancës

konstituive të Kuvendit të Kosovës.

Konjufca tha se aktualisht ekzistojnë dy skenarë: i pari, votimi i një qeverie deri në zgjedhjen e presidentit të ri; dhe i dyti, votimi i një qeverie të re afatgjatë. “Sa i përket kryetarit të Kuvendit, LV-ja ende nuk e ka dhënë emrin e kryetarit të Kuvendit, për arsye se mendoj se të gjitha pozitat sa i përket përbërjes së re të mazhorancës që pastaj do të shndërrohet në qeveri, u nënshtrohen disa principeve e një prej tyre është përpjekja për ta themeluar qeverinë. Kur jemi te qeveria është e pamundur të mos themelohet një koalicion që krijon mazhorancën e aftë për të zgjedhur me 61 vota një qeveri të re. Të gjitha pozicionet, përfshirë atë të kryetarit të Kuvendit, i nënshtrohen këtij principi”, ka thënë Konjufca.

I pyetur për letërën që kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ia ka dërguar kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, Konjufca tha se ftesa “është rasti më normal” në një shoqëri demokratike. “Letra i është drejtuar vetëm LDK-së, kurse gjuhën që do ta përdorim do të jetë një gjuhë e bashkëpunimit, e partneritetit. Mund t’i merrni me mend tensionet dhe polarizimet e mëdha që ndodhin gjatë fushatës, por në fund të fundit të gjithë zgjohemi një mëngjes dhe e shohim se cili është rezultati i zgjedhjeve dhe e kuptojmë se politika nuk ndërtohet mbi urrejtjen e dashurinë”, është shprehur Konjufca. Konjufca ka thënë se ka pasur gjuhë të ashpër edhe nga ana e opozitës në drejtim të tij, por nuk i ka ngelur “hatri”. “Nuk më ka mbetur hatri prej atyre shprehjeve dhe ia zgjati dorën e bashkëpunimit secilit që mund të pajtohem se mund të bëjmë diçka bashkë për shtetin e Kosovës”, ka deklaruar Konjufca. Nënkryetarja e Vetëvendosjes, Albulena Haxhiu, u shpreh e bindur se kryeministër i ri do të jetë Albin Kurti. “Ajo çka dihet tani për tani është emri i kryeministrit. Nuk dihen emrat e personave të tjerë që do të mbajnë pozicione të tjera qoftë në qeveri qoftë në kuvend. Ajo që dihet është se kryeministri i ardhshëm do të jetë Albin Kurti dhe qeveria e ardhshme shumë shpejt do të

votohet”, ka thënë ajo.

Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Uran Ismaili, derisa ka folur për formimin e qeverisë së re dhe qëndrimin e PDK-së, ka thënë se opsionet janë me partitë opozitare. Ismaili para medieve, pas takimit që pati me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, tha se ideja e vijave të kuqe nuk nënkupton vetëm koalicionin, por diçka të caktuar. “Ideja e vijave të kuqe nuk d.m.th gjithmonë në vijën e koalicioneve, por në diçka të caktuar. Si opozitë, sa i përket formimit të qeverisë, i takon partisë së parë ta krijojë qeverinë. Dhe nëse nuk e arrin i takon partisë së dytë ta formojë qeverinë. Ne e kemi një pozicion jashtëzakonisht të qartë, por edhe një besim të madh që e kemi një kandidat që arrin ta formojë një shumicë nëse kemi një paafësi të partisë së parë që ta formojë qeverinë. Jam i bindur që Hamza është një person që pranohet nga një shumicë e caktuar në Kuvend, atëherë kur i vjen rasti”, ka thënë Ismaili. Nënkryetarja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Doarsa Kica-Xhelili, tha se ka “hendonk të madh” mes tyre dhe LV-së. Megjithatë, ajo nuk bëri me dije si do t’i përgjigjet kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ftesës për takim të kryetarit të LV-së, Albin Kurti. “Qëndrimet e LDK-së të dhëna para zgjedhjeve kanë qenë dhe

ofertë publike e LDK-së për cilindo qytetar të Kosovës i cili zgjedh të votojë për LDK-në. Nëse një parti politike në Kosovë e ka shfaqur sheshit një hendonk shumë të madh me LV-në, hendonk ky i cili u shndërrua më pas në një mur të palëvizshëm pas zgjedhjeve, jo vetëm për shkak të diskursit të kryeministrit të vendit, por në përgjithësi për shkak të mënyrës se si ai e ka qeverisur Kosovën në këto katër vjet”, ka thënë ajo. Muharrem Nitaj nga AAK-ja ka thënë se është tejet i komplikuar procesi i krijimit të qeverisë. Ai ka thënë se deri më tani nuk ka shenja se LV-ja i ka siguruar numrat e nevojshëm për krijimin e qeverisë. “Gjithçka mbetet e hapur për opozitën, e cila, si e bashkuar, e ka shumicën, sado që është formulë e komplikuar edhe kjo. Duket se edhe konstituimi i Kuvendit do të jetë një veprim i komplikuar. Në mbledhjen e sotme me kryetarin e Kuvendit u tha se, sipas rregullores, Kuvendi konsiderohet i konstatuar pasi të zgjedhën kryetari dhe pesë nënkryetarët, përfshirë edhe dy nënkryetarët nga radhët e pakicës serbe dhe komuniteteve të tjera joshumicë. Sipas kësaj logjike, është e mundur që konstituimi i Kuvendit të jetë në dorën e Listës Serbe! Krejt po duket se dikush po punon që të bëhet llugë e vendi të shkojë prapë në zgjedhje!”, ka thënë Nitaj.



SHUMICA E DEPUTETËVE NGA PAKICAT THONË SE S'KANË PRESION NGA SERBIA PËR MOSFORMIM TË QEVERISË

PRISHTINË, 8 PRILL - Shumica e përfaqësuesve të zgjedhur nga pakicat joserbe në zgjedhjet e fundit parlamentare kanë mohuar të jenë nën presion nga Serbia për të mos mundësuar formimin e qeverisë së re në Kosovë.

Adem Hoxha, i cili në legjislaturën e fundit u bë pjesë e grupit parlamentar të Listës Serbe, ishte ndër pak deputetët që nuk u përgjigjën në pyetjen e “REL”-it për pretendimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës se Serbia po tenton ta “sabotojë themelimin e institucioneve të reja” dhe legjislaturës së nëntë të Kosovës të dalë nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Njohësit e zhvillimeve politike në vend thonë se mundësia eventuale që Serbia të tentojë ta “sabotojë themelimin e institucioneve të reja” nuk përjashtohet, por Qeveria e Kosovës në detyrë dhe Këshilli i Sigurisë së Kosovës nuk kanë ofruar fakte ose evidencë për ta dëshmuar këtë.

Të dielën, më 6 prill, pas mbledhjes së Këshillit të Sigurisë së Kosovës, të drejtuar nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, Qeveria e Kosovës ka deklaruar përmes një njoftimi për medie, se “Serbia tash po ndërhyr te disa prej deputetëve të komuniteteve joshumicë e joserbë, që ta

sabotojë themelimin e institucioneve të reja të legjislaturës së nëntë”. “Të paktën nga ajo çfarë na është prezantuar [në komunikatën e Qeverisë] nuk ka asnjë evidencë bindëse për ta mbështetur një brengë të tillë, përveç motiveve politike të brendshme”, thotë për “Radion Evropa e Lirë” Albert Krasniqi, nga organizata Demokraci Plus (D+) në Prishtinë.

Zoran Saviq nga organizata joqeveritare Aktiv në Mitrovicë të veriut thotë për “Radion Evropa e Lirë” se akuza e autoriteteve të Kosovës se Serbia po tenton ta “sabotojë themelimin e institucioneve të reja” është e paargumentuar. “Këtu nuk kemi prova konkrete, por janë shfaqur vetëm disa insinuata. Ne nuk kemi as dëshmitë e deputetëve konkretë, për të cilët bëhen pretendimet. Nuk e dimë saktë as për kë bëhet fjalë”, thekson Saviq.

“Radio Evropa e Lirë” i është drejtuar Qeverisë së Kosovës me pyetjen se për cilët deputetë thuhet se Serbia po ndërhyr për ta sabotuar themelimin e institucioneve të reja apo nga cilat komunitete janë ata, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk ka marrë përgjigje. Përgjigje lidhur me këtë çështje nuk ka kthyer as Zyra për

Kosovën e Qeverisë së Serbisë. Lëvizja Vetëvendosje, si parti fituese, në zgjedhjet e 9 shkurtit ka siguruar 48 ulëse në Kuvendin e Kosovës, të cilat nuk mjaftojnë për formimin e shumicës parlamentare dhe për formimin e qeverisë, që kërkon të paktën 61 vota. Kjo parti pëlqen ta formojë qeverinë e re me disa nga partitë e komuniteteve joshumicë - të cilat kanë 20 ulëse të garantuara në Kuvendin e Kosovës. Komunitetet pakicë joserbe kanë dhjetë ulëse, ndërsa Lista Serbe ka fituar nëntë nga dhjetë ulëset që i takojnë komunitetit serb.

Javën e kaluar kryeministri në detyrë i Kosovës, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka mbajtur takime me partitë politike të pakicave, për t’u konsultuar rreth formimit të qeverisë së re të vendit.

Ai nuk është takuar me Listën Serbe.

Çfarë thonë partitë e komuniteteve joshumicë joserbe?

Për të kuptuar nëse ka pasur çfarëdo ndërhyrje apo kontakt nga autoritetet e Serbisë ose nga Lista Serbe, e cila ka mbështetur në Beogradit zyrtar,

Radio Evropa e Lirë ka kontaktuar shumicën e partive politike të pakicave joserbe. Fikrim Damka, kryetar i Partisë Demokratike Turke të Kosovës, e cila ka fituar dy ulëse në Kuvend, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se as ai dhe as bashkëpartia e tij, deputeti i zgjedhur Fidan Jilta, nuk kanë marrë “asnjë telefonatë, asnjë kërcënim dhe asnjë presion” nga kushdo qoftë, për ta sabotuar konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë së re. “Nuk e kemi dhe nuk do të pranojmë diçka të tillë edhe nëse vjen. Jemi të pavarur dhe përfaqësojmë komunitetin turk”, theksoi Damka. Ngjashëm deklaroi edhe Jilta, që tha se nuk ka pasur “kurrfarë presioni”.

Elbert Krasniqi, drejtues i Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës (IRKD), subjekt politik i komunitetit egjiptian, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se nuk është kontaktuar nga askush prej autoriteteve serbe apo nga Lista Serbe lidhur me çështjen e pjesëmarrjes së tij në qeverinë e re. “Nuk ka vend për joshje dhe as për shantazhe të Serbisë dhe askujt tjetër në drejtim timin. Unë jam për qeverinë ‘Kurti 3’ dhe punoj fuqishëm që kjo të realizohet së shpejti”, theksoi Krasniqi, i cili është ende pjesë e qeverisë aktuale në detyrë të

Kurtit. Edhe Emilija Rexhepi nga Partia e Re Demokratike, e cila përfaqëson komunitetin boshnjak, hedh poshtë çfarëdo mundësie të kontaktit me autoritetet e Serbisë apo edhe Listën Serbe. “Jo, dhe s’kam asnjë kontakt me ata. As mesazh, as telefonatë, as kontakt, asnjë gjë”, theksoi Rexhepi.

Edhe Rasim Demiri nga Koalicioni Vakati, i cili, po ashtu, përfaqëson komunitetin boshnjak me një ulëse në Kuvend, thotë se nuk ka pasur asnjë kontakt me autoritetet e Serbisë dhe as Listën Serbe. “Do të thotë, kemi informata se disa duan të bllokojnë institucionet, pra, se nuk duan t’i votojnë. Cilët janë, kush janë ata, nuk e di. Unë jam për [votimin e konstituimit të Kuvendit dhe formimin e Qeverisë]”, theksoi Demiri.

Albert Kinolli nga Partia Rome e Bashkuar, e cila ka siguruar një ulëse në Kuvend, thotë se nuk është kontaktuar nga askush me qëllim shantazhi dhe, sipas tij, “nuk ka gjasa minimale të shantazhohet nga kushdo”. “Asnjëherë nuk ka pasur asnjë bisedim me asnjë palë tjetër, përveçse me njerëzit të cilët i udhëheqin institucionet e Republikës së Kosovës”, tha Kinolli.

KALLASI: VITI 2030, OBJEKTIV REALIST PËR ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË NË BE

PRISHTINË, 8 PRILL - Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian deri në vitin 2030 mund të jetë një objektiv realist nëse kryhen reformat e nevojshme, tha në Tiranë shefja e diplomacisë së BE-së, Kaja Kallas. “Po, është realiste nëse të gjithë bëjnë detyrat e shtëpisë”, ka thënë Kallas.

Por në këtë rrugë, Kallasi tha se Shqipëria duhet t’i bëjë reformat e nevojshme. “Shqipëria me reformat e saj, jo vetëm ato që duhet të miratohen, por edhe ato që tashmë janë miratuar duhet të zbatohen. Këtu sundimi i ligjit është jashtëzakonisht i rëndësishëm, pasi ai, shteti i së drejtës, është një nga themelet e Bashkimit Evropian”, ka deklaruar Kallas.

Në konferencën e përbashkët, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se në fokus të diskutimeve ishte anëtarësimi i Shqipërisë në BE. Rama shprehu ambicien që negociatat e Shqipërisë me BE-në, në kuadër të procesit të anëtarësimit, të mbyllen deri në vitin 2027. “Ne kemi një plan me BE-në për t’i mbyllur negociatat në vitin 2027, që do të thotë se në momentin që mbyllen negociatat, Komisioni u rekomandon vendeve anëtare anëtarësimin”, tha Rama.

Rama tha se Shqipëria parasheh një periudhë dyvjeçare ratifikimesh që, sipas tij, përfundon me anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Këtë rrugëtim, Rama tha se e ndihmon fakti që Shqipëria është në linjë të plotë me politikën e jashtme të Bashkimit Evropian.

Shqipëria i hapi zyrtarisht negociatat për anëtarësim më 15 tetor 2024.

Hapja e kapitujve për Shqipërinë erdhi pas një pritjeje të gjatë,



pasi ajo kishte aplikuar për anëtarësim më 2009 dhe e kishte marrë statutin e vendit kandidat më 2014.

Kallas dhe Rama, po ashtu, folën për rëndësinë që ka stabiliteti në rajon, duke theksuar nevojën për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Gjatë vizitës së Kallasit në Tiranë u nënshkrua një marrëveshje në vlerë prej 90 milionë eurosh për financimin e projektit strategjik të hekurudhës Durrës - Rrogozhinë, pjesë e ‘Korridorit VIII’.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi

Rama, tha se ky segment hekurudhor është një arterie kyçe që do ta “lidhë Shqipërinë me rrjetin evropian të transportit dhe do ta forcojë më tej rolin” e saj si një nyje lidhëse në rajon.

Pse është i rëndësishëm ky projekt?

Projekti ka të bëjë me rehabilitimin e linjës hekurudhore midis Durrësit, Rrogozhinës dhe Linit, në një gjatësi prej rreth 136 kilometrash. Po ashtu, projekti përfshin

ndërtimin e një lidhjeje hekurudhore prej 2.8 kilometrash nga Lini deri në kufi me Maqedoninë e Veriut, në atë që njihet si Korridori Pan-Evropian VIII, i cili lidh Italinë jugore me Detin e Zi në Bullgari, përmes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Ky projekt është pjesë e një plani më të gjerë për ringjalljen e sektorit hekurudhor në Shqipëri. Rrjeti hekurudhor në Shqipëri është kryesisht i vjetruar dhe nuk ka pasur investime të mëdha që nga vënia e tij në funksion.

Në shumicën e rrjetit hekurudhor të Shqipërisë,

shpejtësia maksimale e udhëtimit është rreth 60 kilometra në orë.

Kjo është vizita e parë e Kallasit në Shqipëri që nga marrja e detyrës si përfaqësuese e lartë për politikën e jashtme të BE-së. Një ditë më parë Kallasi qëndroi në Mal të Zi, ndërsa ndalesën e fundit të vizitës në Ballkanin Perëndimor ajo do ta ketë në Bosnjë-Hercegovinë.

Atje pritet të takohet me krerët e Presidencës, me kryetaren e Këshillit të Ministrave, me ministrin e Jashtëm të Bosnjës dhe me përfaqësuesit e forcës evropiane në Bosnjë, EUFOR.

Deputeti i zgjedhur nga Partia e Ashkalinjëve për Integrim, Artan Asllani, nuk ishte i qasshëm, për shkak se ishte jashtë vendit. Por, kryetari i kësaj partie, Etem Arifi, hedh poshtë mundësinë të ketë pasur çfarëdo kontakti me autoritetet e Serbisë. “Te Partia e Ashkanlinjëve për Integrim nuk qëndron kjo, asnjëherë nuk kemi pasur kontakt, ose ndonjë shantazh, ose ndonjë kërkesë prej tyre”, tha Arifi.

“Radio Evropa e Lirë” nuk ka arritur ta kontaktojë deputetin e zgjedhur Adem Hoxha nga Partia Unike Gorane. Ai nuk ka bërë me dije asgjë nga takimi që ka pasur me Kurtin më 3 prill.

Hoxha në legjislaturën e kaluar nuk i takonte ndonjë grupi parlamentar, por pas zgjedhjeve të vitit 2019 ai braktisi grupin Gjashtë Plus të partive të komuniteteve joshumicë joserbe dhe në vitin 2020 u bë pjesë e grupit parlamentar të Listës Serbe.

Mesazheve dhe thirrjeve telefonike të “REL”-it nuk u janë përgjigjur as deputetja e zgjedhur Duda Bale nga subjekti që përfaqëson komunitetin boshnjak Unioni Socialdemokrat, as deputeti i zgjedhur Veton Berisha nga

Partia Liberale Egjiptiane.

“Sikleti i brendshëm” për formimin e qeverisë

Nga shoqëria civile në Kosovë thonë se përmbajtja e njoftimit të Qeverisë së Kosovës, pas takimit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, është e paqartë dhe joserioze.

Albert Krasniqi nga Demokracia Plus thekson se “paqartësia dhe fjalitë e thata” që dolën nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës nuk lënë hapësirë që të merret seriozisht pretendimi se Serbia po ndërhyr në konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë në Kosovë. Sipas tij, motivet e deklaratës së Qeverisë së Kosovës më shumë kanë të bëjnë me problemet që Lëvizja Vetëvendosje ka për sigurimin e 61 votave për formimin e qeverisë së re. “Kur shohim që është zgjeruar lista e partive politike, të cilat po i fton kryeministri [Kurti], më shumë duket që [deklarata] ka ardhur nga një siklet i brendshëm për të siguruar vota ose për ta arsyetuar dështimin për krijimin e institucioneve, duke e fajësuar Serbinë se ka ndërhyrë në këtë proces”, thekson

Takimet e Kurtit me përfaqësuesit e pakicave etnike

Më 2 prill Kurti u takua me kryetaren e Partisë së Re Demokratike nga komuniteti boshnjak, Emilija Rexhepi dhe me udhëheqësin e Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë nga komuniteti serb, Nenad Rashiq. Që të dy shprehën gatishmëri për vazhdimin e bashkëpunimit me LV-në e Kurtit. Një ditë më vonë Kurti vazhdoi takimet me përfaqësuesit e partive të tjera joserbe. Ai u takua me kryetaren e Unionit Socialdemokrat nga radhët e komunitetit boshnjak, Duda

Bale, me kryetarin e Partisë Liberale Egjiptiane, Veton Berisha, kryetarin e Partisë Demokratike Turke të Kosovës, Fikrim Damka, si dhe me kryetarin e Partisë së Romëve të Bashkuar të Kosovës, Albert Kinolli.

Po atë ditë Kurti zhvilloi takim edhe me deputetin e zgjedhur në LV-në. Damka shprehu gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit, ndërkaq nuk dihet se çfarë qëndrimi ka Hoxha sa i përket një bashkëpunimi të mundshëm me partinë e Kurtit.

pjesë e grupit parlamentar të Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë, e cila në zgjedhjet e 9 shkurtit fitoi nëntë ulëse në Kuvendin e Kosovës.

Pas takimeve, Bale, Berisha dhe Kinolli thanë se i kanë paraqitur kërkesat e tyre Kurtit për një bashkëpunim të mundshëm me LV-në. Damka shprehu gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit, ndërkaq nuk dihet se çfarë qëndrimi ka Hoxha sa i përket një bashkëpunimi të mundshëm me partinë e Kurtit.

Krasniqi. Mendim të ngjashëm ka edhe Zoran Saviq nga organizata joqeveritare Aktiv. Megjithatë, ai thekson se deklaratat nga autoritetet e Kosovës, me akuza ndaj Serbisë për ndërhyrje në procesin e krijimit të përbërjes së institucioneve të reja të Kosovës, mund t’i rrisin tensionet ndërmjet dy vendeve. “Këtë po e kuptoj si ngritje

tensionesh, para konstatimit se si do të formohet qeveria. Është e dukshme që Kurti nuk i ka numrat që i ka planifikuar, madje edhe para zgjedhjeve”, thotë Saviq.

Të dy njohësit e zhvillimeve politike vlerësuan se çështjet për të cilat u diskutuan në Këshillin e Sigurisë së Kosovës dhe çështja e ndërhyrjes së pretenduar të Serbisë në

formimin e institucioneve të reja të Kosovës nuk kanë lidhshmëri logjike.

Përveç çështjes së formimit të institucioneve, sipas njoftimit, Këshilli i Sigurisë ka diskutuar edhe për sulmin me granata dore ndaj Zyrës së Postës së Kosovës në Zveçan më 1 prill, por edhe për arrestimin të shtunën mbrëma “të katër ‘pelegrinëve’ serbë në Gjakovë”.

“Fehmi Agani” dhe ATI-KOS nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi për trajnime në fushën e teknologjisë dhe sigurisë kibernetike

PRISHTINË, 8 PRILL - Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë (UFAGj) dhe kompania ATI-KOS sh.p.k., përmes Qendrës së saj të Inovacionit Digjital, kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi (MoU), duke zyrtarizuar bashkëpunimin ndërinstitucional në ofrimin e shërbimeve të trajnimit për studentët në fusha kyçe të teknologjisë së informacionit. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është ofrimi i trajnimeve profesionale dhe praktikave në

Teknologjitë e Rrjetit, Sigurinë Kibernetike dhe Internetin e Gjërave (IoT), me qëllim të rritjes së kapaciteteve teknike dhe përgatitjes më të mirë të studentëve për tregun e punës. Në kuadër të marrëveshjes, ATI-KOS do të ofrojë programe të specializuara trajnimi në ambientet e Qendrës së Inovacionit Digjital, do të bashkëpunojë në zhvillimin e kurrikulës sipas nevojave akademike dhe tregut të punës, si dhe do të organizojë punëtori praktike dhe sesione

trajnimi. Pas përfundimit me sukses të këtyre trajnimeve, studentët do të pajisen me certifikata zyrtare të njohura nga ATI-KOS. Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë rektori i Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë, prof. ass. dr. Drilon Bunjaku dhe drejtori ekzekutiv i ATI-KOS sh.p.k., Fatos Stavileci, të cilët theksuan rëndësinë e këtij partneriteti për zhvillimin profesional të studentëve dhe avancimin e bashkëpunimit ndërmjet



akademisë dhe industrisë. Ky hap shënon një moment të rëndësishëm për UFAGj-në në misionin e saj për të ofruar arsim cilësor dhe të orientuar

drejt praktikës, duke fuqizuar lidhjet me sektorin privat dhe duke krijuar mundësi të reja për zhvillim të qëndrueshëm për studentët.

KURTI KËRKON AVANCIMIN E KËRKESËS SË KOSOVËS PËR ANËTARËSIM NË BE

PRISHTINË, 8 PRILL - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka kërkuar që Bashkimi Evropian ta trajtojë kërkesën e Kosovës për anëtarësim në BE, duke thënë se Kosova nuk ka “plan B”, por është plotësisht e angazhuar për integrim në bllokun evropian. “Ka ardhur koha që Kosova dhe BE t’i shtojë përpjekjet e përbashkëta për t’i tejkaluar pengesat që e pengojnë procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE”, tha Kurti gjatë një diskutimi në Bruksel të organizuar nga Qendra për Studime të Politikave Evropiane (CEPS). “Kjo do të thotë: të iniciohet Pyetësori për Kosovën, për t’i vlerësuar kapacitetet tona institucionale dhe ligjore për anëtarësim në BE; dhe të përgatitet një mendim të bazuar në merita për statusin e kandidatit të BE-së”, shtoi ai. Kosova aplikoi për anëtarësim në BE më 15 dhjetor të vitit 2022. Tani ajo mbetet vendi i vetëm në rajon që nuk e ka ende statusin e vendit kandidat. Vetëm pak orë më herët të hënën, shefja e politikës së jashtme të bllokut evropian, Kaja Kallas, kishte thënë se as Kosova e as Serbia nuk mund të ecin përpara në rrugën drejt BE-së pa normalizim të marrëdhënieve.



E pyetur për ngecjen e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, Kallas tha “ajo çfarë po bëjmë këtë muaj është analizimi” së bashku me të dërguarin e BE-së për dialogun, Peter Sorensen, i cili e mori detyrën në shkurt. Nën ndërmjetësimin e BE-së, në vitin 2023 Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve. Por, prej atëherë, blloku i ka kritikuar të dyja vendet se nuk e kanë zbatuar marrëveshjen pavarësisht se ajo është e detyrueshme për to. Për shkak të krizave në veriun e Kosovës, që rritën tensionet mes dy vendeve, që nga shtatori i vitit

2023 në Bruksel nuk është zhvilluar asnjë raund i dialogut politik, por ka pasur vetëm bisedime në nivel të kryenegociatorëve. Kosovës mund t’i duhen vite të tëra për ta fituar statusin e vendit kandidat, pasi që edhe vendet e rajonit kanë pritur ngjashëm - si Shqipëria që priti pesë vjet, dhe Bosnjë-Hercegovina gjashtë vjet. Megjithatë, disa vende, si Ukraina dhe Moldavia, priten vetëm disa muaj për ta fituar këtë status. Kurti vuri theksin në arritjet e Kosovës në fushën e reformave dhe implementimit të standardeve të BE-së, duke

përmendur angazhimin e Kosovës për ta ndihmuar Ukrainën me ndihma ushtarake dhe të qenit në vijë me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së (CFSP). Kosova ka dënuar luftën e paprovokuar të Rusisë kundër Ukrainës dhe ka mbështetur sanksionet ndërkombëtare ndaj Rusisë dhe aleatëve të saj. “Kosova është një partnere e besueshme e BE-së dhe beson fuqishëm në të ardhmen e saj evropiane”, deklaroi Kurti. Ai theksoi se është koha që Bashkimi Evropian të tregojë se e sheh Kosovën pjesë të së ardhmes së tij, duke forcuar kështu angazhimin e Kosovës për agjendën evropiane. Kurti gjithashtu kritikoi vonesat e procesit të zgjerimit dhe theksoi se qytetarët e rajonit, sidomos të rinjtë, janë të shqetësuar për ngadalësimin e këtij procesi, duke pasur parasysh se besimi në BE është duke u shuar. Vendeve që i janë bashkuar BE-së në vitet 2004, 2007 dhe 2013 - tri zgjerimet e fundit të bllokut evropian - u janë dashur nga tetë deri në 14 vjet që nga dorëzimi i aplikimit e deri tek anëtarësimi në BE. Ky proces merr kohë, pasi që vendi kandidat duhet t’i përmbushë disa kritere, t’i

përshtatë ligjet e veta me ato të BE-së, si dhe ta presë ratifikimin e traktatit për anëtarësim në parlamentet e secilit vend anëtar të BE-së. Kriteret për aplikim - të njohura si “Kriteret e Kopenhagës” - kanë të bëjnë me stabilitetin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe funksionalitetin e tregut ekonomik. Për vendet e Ballkanit Perëndimor janë vendosur edhe disa kushte shtesë, të përcaktuara përmes Procesit të Stabilizim-Asociimit. Kroacia, vendi i fundit që iu bashkua BE-së, në vitin 2013 - kishte aplikuar për anëtarësim më pak se një vit e gjysmë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Por, i gjithë procesi deri në anëtarësimin e Kroacisë kishte zgjatur 12 vjet. Rrugëtimi i Kosovës mund të jetë më i ndërlikuar sesa ai i Kroacisë, pasi kjo do të jetë hera e parë që një shtet aplikon për anëtarësim pa u njohur zyrtarisht nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Shtetet që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës janë Spanja, Rumania, Qipro, Greqia dhe Sllovakia. Kosova kishte arritur Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në, që u nënshkrua në Strasburg më 17 tetor të vitit 2015.

Zyrtarët e KQZ-së dhe të shoqërisë civile në ShBA marrin pjesë në programin e Zyrës së Kongresit Amerikan për Leadership Ndërkombëtar

PRISHTINË, 8 PRILL - Zyrtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe përfaqësues të shoqërisë civile vizituan Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kuadër të “Open World Program” i administruar nga Zyra e Kongresit Amerikan për Leadership Ndërkombëtar (COIL). Delegacioni i KQZ-së, i përbërë nga Burim Ahmetaj, Valmir Elezi, Nexhmedin Hyseni, Vuksan Vuksanovic, si dhe

përfaqësuesja e Institutit Demokratik të Kosovës, Violetë Haxholli, me mbështetje nga përfaqësuesja e Ambasadës së ShBA-së në Kosovë, Laura Bajrush, fillimisht qëndroi në Uashington, DC. Gjatë kësaj kohe në Bibliotekën e Kongresit u organizuan disa sesione të ndryshme, ku u prezantuan praktikat e qeverisjes në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me theks të veçantë për funksionimin e federalizmit

amerikan dhe rolin e udhëheqjes në kuadër të kulturës amerikane. Pjesa e dytë e programit për zyrtarët e KQZ-së u zhvillua në shtetin e Pensilvanisë, ku u prezantua modeli amerikan i votimit dhe praktikat e menaxhimit të procesit zgjedhor. Gjatë qëndrimit disaditor u organizuan takime të shumta, me drejtues të institucioneve qendrore dhe lokale, me të cilët



u diskutua për mënyrën se si ushtron veprimtarinë Qeveria e shtetit të Pensilvanisë, por edhe

me drejtues të institucioneve lokale që merreshin me organizimin e zgjedhjeve.

NË PËRBALLJE FITIMTARE



Shkruan: Ismail SYLA

1. Sot bëhen 9 vjet që nga dita kur lideri politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kryetari i parë i Partisë Demokratike të Kosovës, kryeministri i Pavarësisë së Kosovës, Hashim Thaçi, u inaugurua solemnisht president i Republikës së Kosovës në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë. Zgjedhja e Hashim Thaçit president i vendit në Kuvendin e Kosovës më 26 shkurt 2016, në ceremoninë e lartë shtetërore të 8 prillit 2016, simbolikisht sintetizoi rrugën e tij politike të ngjeshur: nga lufta çlirimtare në përfaqësimin më të lartë kushtetues. Në këtë mision të lartë institucional Hashim Thaçi mishëronte burrështetasin që mund të sillte stabilitet kombëtar, përfaqësim të fuqishëm ndërkombëtar dhe lidhshëm në përballje me Serbinë në procesin e dialogut. Në fjalimin e inaugurimit, presidenti Thaçi theksoi: "Unë do të jem president i të gjithë qytetarëve, i unitetit, i kushtetutshmërisë dhe i dinjitetit shtetëror."

2. Kur më 5 nëntor 2020, Prokuroria e Dhomave të Specializuara në Hagë shpalli fletarrestin, Hashim Thaçi nuk priti presion ndërkombëtar. Ai dërgoi një mesazh të qartë institucional dhe moral: "Për të mbrojtur integritetin e presidencës dhe për të ruajtur dinjitetin e popullit dhe shtetit të Kosovës, jap dorëheqje." Nga njëra anë, dorëzimi vullnetar i tij nuk ishte akt nënshtrimi, por një vazhdim i kulturës së lirisë me mjete të tjera: duke i besuar shtetit që e ndihmoi të krijojë dhe drejtësisë ndërkombëtare, që ai e kishte përkrahur në parim. Por, nga ana tjetër, ky akt shpërfaq paradoksin thelbësor të burgosjës së Hashim Thaçit. Gjykata Speciale, që gjykon vetëm pjesëtarët e UÇK-së, është kontestuar gjerësisht në opinionin publik kosovar, për shkak të karakterit të njëanshëm dhe mungesës së denoncimit dhe gjykimit të krimeve shtetërore serbe. Si mundet një njeri që ndihmoi në çlirimin dhe themelimin e një shteti, të përfundojë në burg, nën akuzë për krime gjatë luftë? Ky veprim përmban një nga paradokset më të thella në Kosovën e pasluftës, por edhe qëndrimin ofendues dhe të njëanshëm të botës demokratike. Ata që ishin agresorë, sot janë sërish në pushtet në Serbi. Ata që ishin çlirimtarë, sot janë


në burg, në Hagë. Në parim drejtësinë nuk e konteston askush. Por drejtësia e selektuar nuk sjell gjykim të drejtë, as satisfaksion, as pajtim. Ajo sjell dhembje të reja dhe thyerje simbolike të dinjitetit kolektiv. 3. Pavarësisht akuzave, Hashim Thaçi nuk është i braktisur nga historia. Ai mbetet një figurë që përfaqëson një brez të tërë të lëvizjes kombëtare shqiptare. Qëndrimi i tij në Hagë është

dëshmi e gatishmërisë për të mbrojtur jo vetëm veten, por dhe parimet mbi të cilat ai ndërtoi jetën politike. Thaçi nuk u rrëzua nga pushteti me dhunë apo me grusht shteti. Ai doli vetë nga zyra presidenciale për të hyrë në një dhomë burgu, ku historia, drejtësia dhe fati po përplasen rreptë. Nuk u arrestua, u dorëzua. Nuk u mposht, por qëndron. Në Hagë, Kosova po përballet me dilemën se si ta ruajë të vërtetën

e luftës, ndërsa përqafon "drejtësinë ndërkombëtare". Më 5 nëntor 2020, Kosova nuk humbi thjesht një president. Hashim Thaçi është më shumë se një emër. Ai është një udhëtim i gjallë i një kombi që luftoi për ekzistencë, krijoi shtet dhe tani, për katër vjet e gjysmë, po përballet me Gjykatën Speciale në Hagë. E, sipas logjikës dhe trajektoreve të arritjeve të tij historike, ai, Hashim Thaçi, gjithmonë del fitimtar.



DITA NDËRKOMBËTARE E ROMËVE, OSMANI VLERËSON LART KONTRIBUTIN E KOMUNITETIT ROM



PRISHTINË, 8 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve, ka pritur të martën në takim një delegacion të Partisë së Romëve të Bashkuar të Kosovës, kryesuar nga Albert Kinolli. Presidentja Osmani uroi kryetarin Kinolli dhe të gjithë qytetarët e komunitetit rom në Kosovë, duke theksuar rëndësinë e kësaj dite për të reflektuar mbi sfidat dhe arritjet, si dhe për ta riafirmuar përkushtimin institucional ndaj të drejtave dhe barazisë së komunitetit rom. Gjatë takimit presidentja vlerësoi lart kontributin e përfaqësuesve të komunitetit rom në përgjithësi për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse, duke cilësuar zërin e tyre si thelbësor në proceset demokratike të

vendit. Duke nënvizuar angazhimin e vazhdueshëm për fuqizimin e komuniteteve joshumicë në Kosovë, Osmani vlerësoi punën e Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe mekanizmeve të tjerë që synojnë fuqizimin e pjesëmarrjes dhe avancimin e të drejtave të komuniteteve, me theks të veçantë për komunitetin rom. Presidentja Osmani potencoi se arsimi mbetet një nga prioritetet kryesore në fuqizimin e të rinjve rom, veçanërisht vajzave dhe grave, përmes programeve që rrisin qasjen dhe përfshirjen në sistemin arsimor. Ajo shtoi se përkushtimi për barazi nuk duhet të përqendrohet vetëm në arsim, por edhe në krijimin e mundësive të barabarta për punësim dhe përfshirje aktive në jetën publike dhe institucionale të vendit.

Deçani nderon me titull "Qytetar Nderi" gjeneralin amerikan Arthur Garffer

DEÇAN, 8 PRILL - Komuna e Deçanit ka nderuar me titullin "Qytetar Nderi" gjeneralin amerikan Arthur Garffer. "Deçani nderoi një

mik të madh të Kosovës, Gjeneralin amerikan Arthur Garffer, me titullin 'Qytetar Nderi'. Ky vlerësim buron nga zemrat e njerëzve të Deçanit

dhe i dedikohet jo vetëm kontributit personal të Gjeneral Garffer, por edhe secilit ushtar amerikan që ka dhënë kontribut për lirinë e

popullit tonë dhe sot shërbejnë me përkushtim për paqe e siguri në Kosovë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



Rizvanolli i kërkon ZRRE-së të mos shtrenjtohet rryma për konsumatorët më të vegjël

PRISHTINË, 8 PRILL - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka bërë me dije se i ka propozuar Zyrës së Rregullatorit për Energji që të mos rritet çmimi i energjisë elektrike për konsumatorët që shpenzojnë më pak se 800 kWh në muaj. Ndërsa për pjesën tjetër të konsumatorëve, Rizvanolli thotë se Ministria e Ekonomisë ka propozuar që konsumatorët të ndahen në sa më shumë kategori. “Të mos trajtohet njëjtë për shembull, sikur dikush që shpenzon 1 000 kWh në muaj, si dikush që shpenzon 3 000 kWh në muaj. Në këtë mënyrë ne mbrojmë familjet sa më shumë që të jetë e mundur, pa e cenuar sigurinë e furnizimit, veçanërisht i mbrojmë ata të cilët kanë nevojë më së shumti”, tha Rizvanolli në një video të publikuar në “Facebook”. Aktualisht për konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë brenda një muaji, çmimi i rrymës gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat, ndërsa për ata që

shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë, pjesa mbi këtë u llogaritet me çmim prej 14.45 centësh. Nga ora 22:00 deri në 7:00 të mëngjesit çmimi për kilovat është 3.34 centë për ata që shpenzojnë deri në 800 kilovatë dhe 6.81 centë për ata që shpenzojnë më shumë. Më herët gjatë ditës, Zyra e Rregullatorit të Energjisë e Kosovës (ZRRE) ka thënë se tarifat e reja të rrymës pritet të hyjnë në fuqi më 1 maj. Rregullatori i energjisë propozoi muajin e kaluar shtrenjtimin e çmimit të energjisë elektrike në vend për rreth 15 për qind, duke nxitur reagime dhe protesta. Bordi i ZRRE-së pritet të marrë vendim për çmimin e rrymës më 11 prill. Shtrenjtimi i rrymës u kundërshtua nga Presidenca dhe nga qytetarë që protestuan të shtunën në kryeqytet. ZRRE-ja bën shqyrtimin dhe caktimin e përvitshëm të tarifave të rrymës, të cilat shpallen çdo vit më 1 prill dhe

vlejnë deri më 31 mars të vitit pasues. Javë më parë tri kompanitë e sektorit të energjisë në Kosovë i kërkuan rregullatorit të energjisë rritjen e çmimit të tarifave të rrymës. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Kompania për Distributim të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) kërkuan ngritjen e çmimit të tarifave të rrymës për shkak të importit të energjisë elektrike. ZRRE-ja ka argumentuar se rritja e tarifave këtë vit është e domosdoshme, për shkak të uljes së prodhimit të energjisë, rritjes së konsumit dhe varësisë së madhe nga importet me çmime të larta. Kosova nuk mund ta sigurojë energjinë e nevojshme për mbi 1.6 milion banorët e saj vetëm me prodhimin nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Një nga arsytet është vjetërsia me dekada e termocentraleve



“Kosova A” dhe “Kosova B”. Prodhim ka edhe përmes burimeve të ripërtërishe, por në sasi më të vogla. Përfaqësuesit e bizneseve kanë thënë më herët se rritja eventuale e çmimit të rrymës do t'i rriste kostot operative të bizneseve. Kjo më pas do t'i detyronte bizneset ta rrisnin çmimin e produkteve dhe shërbimeve të tyre, duke i bërë ato më pak konkurruese në treg. Kosova vitet e fundit është

përballur me rritje të vazhdueshme të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve. Shtrenjtimi ka nisur në kohën e pandemisë Covid-19 në vitin 2020 dhe ka marrë hov pasi Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 2022. Vitin e kaluar ZRRE-ja uli çmimin për konsumatorët komercialë dhe industrialë për 3 për qind. Por, një vit më herët, më 2023, tarifat u rritën për 15 për qind për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Qeveria vendos marzhë fitimi për naftëtarët

PRISHTINË, 8 PRILL - Me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve dhe konkurrencës së ndershme në tregun vendor, ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka nënshkruar vendimin për rregullimin e çmimeve dhe vendosjen e masave të tjera mbrojtëse për produktet e naftës të përdorshme në transport. Ministria Hajdari ka theksuar se ky vendim është rezultat i mbikëqyrjes së vazhdueshme të tregut të produkteve të naftës, ku si rezultat është evidentuar se, ndryshimet e çmimeve furnizuese nga importi reflektohen menjëherë në rritje të çmimeve shitëse në tregun vendor, por jo edhe kur bien çmimet furnizuese nga

importi i produkteve të naftës. Këto të dhëna janë nga evidencat e përditshme të Doganës së Kosovës dhe raportet e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut. Sipas këtij vendimi, përcaktohet: marzha tregtare maksimale e lejuar e shitjes me shumicë në dy (2) euro centë për litër dhe marzha tregtare maksimale e lejuar e shitjes me pakicë në dymbëdhjetë (12) euro centë për litër. Po ashtu, ky vendim i detyron subjektet për t'u furnizuar me produkte dhe për të ofruar për shitje produktet e naftës, pa ndërprerje, si dhe t'i respektojnë çmimet me marzhën tregtare maksimale të lejuar dhe të tjera masa



mbrojtëse të përcaktuara. Po ashtu, zbatimi i këtij vendimi parasheh mbikëqyrje të shtuar inspektuese, paraqitjen e rasteve të dyshimta te Autoriteti i Konkurrencës, si dhe bashkëpunim të ngushtë të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut me Doganën dhe Administratën Tatimore të Kosovës. Ministria Hajdari ka theksuar se ky vendim është një hap tutje drejt promovimit të konkurrencës së ndershme të tregut dhe mbrojtjes së konsumatorëve, duke parandaluar sjelljet antikonkurruese, duke siguruar transparencë dhe kushte të barabarta në tregun e Republikës së Kosovës.

AUV-i: Mishi i bardhë në tregun e Kosovës është i sigurt

PRISHTINË, 8 PRILL - Bakteria “salmonelë”, e gjetur në mishin e bardhë në Shqipëri ditë më parë, ka alarmuar edhe Kosovën. Kontrollat janë ashpërsuar në Kosovë nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) për këtë mish që importohet nga Brazili. AUV-i ka njoftuar se mishi i bardhë i pulës i cili tregtohet në Kosovë është i sigurt për konsum dhe i plotëson kriteret për tregtim. “Të gjitha rezultatet e analizave konfirmojnë, se mishi i bardhë i pulës që tregtohet në Kosovë është i sigurt. Pas ngritjes së dyshimeve se mishi i pulës me origjinë nga Brazili kishte



rezultuar pozitiv në Shqipëri, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë kishte ndërmarrë

veprime për t'i hequr dyshimet për konsumatorin kosovar. Me një gjurmim të potë, duke

vendosur masa shtesë kontrolli, përfshirë edhe marrjen e mostrave, kufizime të shitjes deri në konfirmim përmes rezultateve të analizave laboratorike. Sot janë nxjerrë rezultatet, të cilat kanë konfirmuar se mishi i cili ka qenë duke u tregtuar dhe ai që ishte duke u importuar, është i sigurt për konsum dhe i plotëson kriteret ligjore për tregtim”, ka njoftuar AUV-i. Sipas këtij njoftimi, është thënë se mostrat e mishit të pulës (fileto-breast) me origjinë nga Brazili janë testuar në aspektin mikrobiologjik, në parametrat e pranisë së Salmonella Typhimurium dhe Salmonella Enteritidis. “Testet

janë kryer me ANSR metodë e avancuar për amplifikimin e ADN-së së Salmonelles spp. Të njëjtat janë konfirmuar edhe me metodën klasike e bazuar në ISO 6579-1. Limitet e përcaktuara sipas rregullores për kriteret mikrobiologjike në produktet ushqimore nr. 27/2012, si dhe plotësim-ndryshimit 09/2018. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë gjithmonë do të veprojë konform legjislacionit në fuqi për t'i hequr dyshimet e konsumatorit mbi çdo pasiguri në produkte. Po punojmë çdo ditë që për sigurinë e ushqimit në vend, të besohet si fakt dhe si perceptim”, ka njoftuar AUV-i.

RRËMBYTES ZEMRASH, MASHTRUES, POET DHE SPIUN: KUSH ISHTE NË TË VËRTETË CASANOVA?

Ai u bë i famshëm për aventurat e tij të dashurisë, por Casanova qe edhe prift, shkrimtar, diplomat dhe spiun. Ai lindi në Venecia para 300 vjetësh – dhe emri i tij njihet ende në gjithë botën.

Giacomo Girolamo Casanova shikon me admirim figurën e tij të gjatë e të hollë në pasqyrën e zbukuruar me ar dhe rregullon disa qime të parukes. Çdo gjë duhet të jetë perfekte, kur të vijë zonja e zemrës së tij. Oxhaku dhe mobiliat e bukura reflektohen në dritën e qirinjeve të shumtë, lulet në tapetet e mureve duket sikur kërcëjnë në dritën vezulluese. Midhjet, mishi i drerit dhe shampanja janë gati mbi tavolinë. Bukuroshja, që ka pritur Casanova, është e mahnitur nga skena që ai ka përgatitur. Pas darkës mashtruesi e josh atë në dhomën e gjumit, ku ata i jepen lojës së dashurisë mes mëndafshit dhe damaskut. Pak a shumë kështu mund të imagjinohen takimet e Casanovës me të dashurat e tij, bazuar në memualet, që ai la pas.

"Meqë e ndjeja veten të lindur për seksin e kundërt, gjithmonë e kam dashur atë dhe e kam lënë që të më dojë, aq fort sa kam mundur", shkruan Casanova në kujtimet e tij, "Historia e jetës sime". Aty ai përmend me emër 116 dashnore, megjithëse historianët supozojnë se ai kishte marrëdhënie dashurie me disa mijëra. Këtu përfshiheshin zonja të shtresës së lartë dhe vajza nga familje të mira, por edhe prostituta e madje dy murgesha.

Casanova nuk u martua kurrë

Në lidhjet e tij të shumta bëjnë pjesë edhe Marie-Louise O'Murphy, e dashura e mbretit francez Louis XV. Apo ajo Henrieta, të cilën ai e ndan nga një oficer hungarez në Itali, dhe që kur i thotë lamtumirë në Gjenevë, ajo gërvisht me një diamant në xhamin e dritares së dhomës së bujtinës fjalët: "Do ta harrosh edhe Henrieten!" Ai shpesh u premntonte martesë zonjave, por nuk u martua kurrë. Dhe megjithëse ato ishin në dijeni për jetën e tij të paqëndrueshme, bien pre e sharmit të tij.

Por Casanovës i bëhet padrejtësi, nëse e sheh atë vetëm si don zhuan, thotë italianii Carlo Parodi, i cili në 2018 hapi në Venecia një muze për bashkatdhetarin e tij të famshëm (muzeu nuk i mbijetoi pandemisë së koronës, shënimi i redaktorit). "Casanova", thekson

ai, "ishte një mendimtar, shkrimtar dhe filozof i madh, i cili padrejtësisht ka hyrë në histori vetëm si një dashnor i madh".

Fëmijëria dhe vitet e shkollimit

Giacomo Girolamo Casanova lindi më 2 prill 1725 si djali më i madh i një familjeje aktorësh. Duke qenë se prindërit e tij shkojnë shpesh në turne, e lënë atë në kujdesin e gjyshes Mariza. Në moshën 12-vjeçare ai studion drejtësi laike dhe kishtare në universitetin e Padovës dhe në moshën 17-vjeçare doktoron. Karrierën e tij priftërore nuk e përfundon, jo sepse bie i dehur nga foltorja gjatë predikimit, por sepse pas tre vjetësh profesioni nuk e tërheq. Dhe shporta me ndihmat për kishën nuk mbushej aq shumë me monedha sesa me letra pasionante dashurie.

Ai provon fatin në profesione të ndryshme: është sekretar, kadet, toger, violinist në orkestër, poet dhe shkrimtar, alkimist, agjent sekret i inkuizicionit, spekulues financiar, diplomat dhe bibliotekar - për të përmendur vetëm disa nga aktivitetet e tij të shumta.

Për Casanovën bota e njerëzve të vegjël, nga e cila vjen, është një tmerr. Ai dëshiron t'u përkasë atyre, që i admiron me verbëri: patricëve. Edhe pse nuk i pëlqen mendjemadhësia i aristokracisë, jetën e tyre komode dhe luksoze e dëshiron shumë. Pasi Casanova ndihmon senatorin e respektuar Matteo Bragadin, në momentin kur ai pëson një goditje cerebrale, ky bëhet mbrojtësi i tij.

"Kushdo që të jesh", i tha ai atëherë 21-vjeçarit, "nga ti e kam jetën". Nga ai moment ai përfiton ushqim dhe banim, një shërbëtor, një gondolë, dhjetë dukatë ari në muaj si para xhepi dhe premtimin e patronazhit të tij të përjetshëm. "Kjo", thotë Casanova, "është e gjithë historia e metamorfozës sime dhe e kohës së lumtur, ku unë nga pozita e një violinisti të varfër u ngrita në atë të një zotërie të nderuar".

Arratisje spektakolare nga dhomat e plumbit

Casanova shpejt bëhet i



preferuari shoqërisë së lartë. Ai ka një formim të shumanshëm, qoftë në teologji, alkimi, mjekësi apo matematikë, -veneciani është në gjendje të diskutojë për çdo temë. Përveç italishtes, ai flet edhe frëngjisht, greqisht dhe latinisht, dhe është një bashkëbisedues argëtues. Kështu që nuk e ka të vështirë të magjepsë njerëzit. Por ai vazhdimisht shkaktonte zemërimin e klasës së lartë. Kështu më 26 korrik 1755 ai burgoset në dhomat famëkeqe të plumbit, një burg në papafingon e Pallatit të Dozhëve venecianë me çati prej plumbi. Ai akuzohet për blasfemi dhe "fyerje të fesë së shenjtë", për posedim të librave të ndaluar, për praktikim të magjisë dhe për joshje të të rinjve në ateizëm. Gjasat më të mëdha janë, hamendëson Casanova, që inkuizitorin e shtetit Condulmer e ka bërë armik për shkak të dashurisë së një zonje, të cilën vetë Condulmer e dëshiron. Giacomo vuan nga ethet dhe të dridhurat, pleshtat i thithin gjakun dhe në birucë nuk ka ajër. "I vetmi mendim që më sundonte, ishte arratisja", shkroi ai më vonë. Deri tani askush nuk ka ikur ndonjëherë nga dhomat e plumbit, por Casanova arrin të shpëtojë. Ai shkon në Paris, ku historia e arratisjes së tij spektakolare është përhapur tashmë dhe ai pritët si hero.

Xhongler financiar

Casanova është një mashtrues i shkëlqyer. Ai vazhdimisht gllabëron shumën të mëdha parash, që shpirtat naivë, veçanërisht gratë, ia besojnë atij. Për shembull, Madame d'Urfé, një nga aristokratet më të pasura të Francës. Ajo është e fiksuar pas ideve okulte dhe është e etshme për t'u rinuar nga mrekullitë. Casanova mund ta verbojë atë me njohuritë e tij në

alkimi dhe meqenëse, siç rrëfen ai në kujtimet e tij, nuk mund ta largojë markezën nga bindja e saj e rremë, preferon t'ia zhvatë asaj paratë nga xhepi.

Një fitim të papritur i solli atij edhe ideja për të themeluar një llotari në Francë në vitin 1757; pozita e drejtorit është jashtëzakonisht fitimprurëse. Arka e tij vazhdon të mbushet. Me porosi të fshehtë të ministrit të jashtëm francez ai kryen transaksione të vështira financiare në bursë jashtë vendit.

Por megjithë të ardhurat e tij marramendëse Casanova është vazhdimisht i falimentuar, sepse shpenzon para me të dyja duart dhe është i varur nga bixhozi. Por për shkak të sjelljes absolutisht të sigurt në vetvete - pas vitit 1758 ai prezantohet me guxim me titullin aristokratik të vetëshpallur "Chevalier de Seingalt" – gjenden vazhdimisht njerëz të rangut të lartë, që hyjnë për të garant me letra rekomandimi lavdëruese. Megjithatë gjërat nuk shkojnë gjithmonë mirë për bon vivantin: ai përfundon në burg gjashtë herë gjatë jetës së tij dhe dëbohet nga po aq vende.

Në udhëtim pa pushim

Gjatë gjithë jetës së tij Casanova udhëton nga një oborr mbretëror në tjetrin në të gjithë Evropën. Talenti i tij, për të lëvizur gjithmonë në rrethet më të larta, i krijon atij kontakte të shkëlqyera. Ai takon Mozartin dhe Volterin dhe në Romë takohet me papa Klementin XIII, i cili e shpall kalorës të spurit të artë. Frederiku i Madh i ofron atij një pozicion si mësues në shkollën e junkerëve në Pomerani, të cilin ai e refuzon. Mbretëresha e Rusisë Katerina e Madhe e priti dy herë radhazi. Vështirë se ndonjë nga

bashkëkohësit e Casanovës mund të ketë udhëtuar aq shumë sa veneciani: historianët kanë llogaritur se gjatë jetës së tij ai ka përshkuar një distancë të barabartë me perimetrimin e tokës. Me mjetet e transportit të asaj kohe, mbi kalë, në karrocë apo me anije, kjo ishte një arritje e jashtëzakonshme. Kur u kthye në Venecia në vitin 1774 pas 17 vjetësh në mërgim, ai ishte i rraskapitur fizikisht; Vendlindja e tij, dikur skenë për orgjitë e tij të shumta, nuk e tërheq më.

Ajo që lë pas

Casanova ishte 60 vjeç, i vetmuar dhe i hidhëruar, kur u punësua si bibliotekar i kontit Waldstein në kështjellën Dux të Bohemisë në vitin 1785. Pesë vjet më vonë ai filloi të shkruante kujtimet e tij. Ai qëndron deri në nëntë orë në ditë mbi dorëshkrim, dhe shkruan 3700 faqe. Më 4 qershor 1798 Casanova vdes në moshën 73 vjeçare si pasojë e sifilizit apo sëmundjes së fshikëzës urinare, nuk dihet me siguri. Ai bie në harresë.

Kujtimet e tij mbahen të fshehta deri në shekullin e 20-të, censuruesit nuk i tolerojnë përshkrimet e lira të aventurave të tij seksuale. Vepra shitet fshehurazi nën dorë. Por kur më në fund ajo publikohet, e bën atë të pavdekshëm. Ajo ofron një pasqyrë unike të jetës dhe shoqërisë së asaj kohe dhe përkthehet në 20 gjuhë. Në të njëjtën kohë ai është dorëshkrimi më i shtrenjtë i shkruar me dorë në botë: në vitin 2010 shteti francez e blen atë për shtatë milionë euro. Vendndodhja e varrit të Casanovës sot nuk dihet më, por motoja e jetës së tij është: "I kam dashur gratë deri në çmenduri", por "gjithmonë e kam dashur më shumë lirinë time"./DW



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Drita ‘blindon’ trajnerin Ramadani

GJILAN, 8 PRILL - Skuadra e Dritës së Gjilanit, e kënaqur me ecurinë e rezultateve pozitive dhe punën konkrete që ka bërë trajneri Zekrija Ramadani, ka vendosur ta vazhdojë bashkëpunimin edhe për dy vjet të tjera me trajnerin në fjalë. “Puna e mirë duhet të vazhdojë. Në ambientet e

klubit, në prani të drejtorit gjeneral Feti Murseli, është zyrtarizuar vazhdimi i bashkëpunimit me trajnerin Zeko Ramadani edhe për dy vjet të tjera. Besimi i klubit ndaj trajnerit Ramadani vazhdon të mbetet i palëkundur në atë që klubi ka projektuar që nga dita e parë

kur Zeka iu bashkua ekipit tonë. Së bashku për misione të reja! Paç fat, trajner!”, thuhet në njoftimin e Dritës. Skuadra gjilanase aktualisht është në vendin e parë në Albi Superligën e Kosovës me 60 pikë, 13 më shumë se vendi i dytë, Ballkani, pas xhiros së 27 të Superligës së Kosovës.



Sot gjysmëfinalja e parë Drita - Prishtina, nesër përballen Llapi - Drenica

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 PRILL - Gara e Kupës në futbollin e Kosovës po shkon drejt fundit dhe sot (e mërkurë) dhe nesër (e mërkurë) do të zhvillohen dy ndeshjet e para gjysmëfinale. Kryesuesja e elitës, Drita, e pret në Gjilan rivalen e vjetër, Prishtinën, me synim që të fitojë me rezultat të mirë dhe në ndeshjen kthyesë mos të ketë telashe për ta siguruar kualifikimin në finalen e madhe. Në anën tjetër, kryeqytetasit kanë bërë ndryshime teknike në shtabin



vendin e parafundit në Superligë dhe trajneri Tahir Batatina ka synime të mëdha në Kupë në mënyrë që të mos ketë një sezon dështues. Në anën tjetër, Drenica, që bën gara në Ligën e Parë, aktualisht është në vendin e parë dhe ka synime të mëdha edhe në garën e Kupës, ku synon që fillimisht ta kalojë Llapin e më pas të fitojë edhe në finalen e madhe. Me synim për t'i arritur objektivat, skuadra kuqezi e ka rikthyer në krye të shtabit teknik trajnerin me përvojë të madhe, Bylbyl Sokolin. “Me një histori të pasur në zhvillimin e futbollit dhe drejtimin e skuadrave të njohura, besojmë se përvoja dhe vizioni i Sokolit do të jenë vendimtare për ta ndihmuar klubin t'i arrijë objektivat e tij”, thuhet, ndër të tjera, në njoftimin e skuadrës nga Skenderaj me rastin e rikthimit të Sokolit.

GJYSMËFINALJA E KUPËS
Të mërkurën takohen:
15:30 Drita - Prishtina
Të enjten takohen:
15:00 Llapi - Drenica

teknik pas rezultateve jo të mira. Në vend të francezit Jean-Michel Cavallin e kanë emëruar trajnerin Arsim Thaqi. Prishtina pret rezultat pozitiv nga ndeshja e parë dhe në ndeshjen e dytë si vendas të kenë më të lehtë që ta arrijnë

synimin, pasi Kupa është rruga më e lehtë për të marrë pjesë në garat evropiane dhe mënyra më e lehtë për të përmbyllur një sezon të suksesshëm për faktin se në elitë janë në pozitën e pestë. Të enjten zhvillohet gjysmëfinalja tjetër,

ku do të përballen Llapi dhe Drenica. Edhe kjo ndeshje fillon nga ora 15:00 derisa është paraparë të zhvillohet në stadiumin “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Llapi ka pasur një edicion jo të mirë për faktin se momentalisht renditet në

Statistikat e Superligës në basketboll

PRISHTINË, 8 PRILL - Garat e rregullta përfunduan në ProCredit Superligë. “Qershia mbi tortë” do të jetë “play-off”-i i elitës së basketbollit. FBK-ja sjell statistikën e skuadrave të ProCredit Superligës për 28 xhiro. Pikë më së shumti shënoi Sigal Prishtina, 2 316 apo 82.71 për ndeshje, duke u ndjekur nga Trepça me 81.51 pikë për ndeshje. Sa iu përket kërcimeve, prin Peja me 1191

apo 42.54 për ndeshje. Bardhekaltrit janë në pozitën e dytë me 41.5 për ndeshje. Lideri Bashkimi është në vendin e parë sa iu përket asistimeve me 543 në total apo 19.39 për ndeshje. Mitrovicasit janë në pozitën e dytë me 18.14. Ndërkohë, për topa të vjedhur, Bashkimi sërish është lider me 223 në 28 sfida, apo 7.96 mesatarisht për ndeshje, ndërsa Golden Eagle Ylli është në pozitën e dytë me 7.93. Te

STATISTIKAT E SUPERLIGËS			
Sigal Prishtina	pikë	2 316	
Peja	kërcime	1 191	
Bashkimi	asistime	543	
Bashkimi	topa të vjedhur	223	
Bllokada	bllokada	97	

bllokatat, Bashkimi sërish është lider me 97 bllokada ose 3.46 për ndeshje, duke u ndjekur nga Ylli me 3.21 për ndeshje.



Emërllahu pas lëndimit: Nuk do të mungoj asnjë ditë

CLUJ-NAPOCA, 8 PRILL - Mesfushori i CFR Cluj, Lindon Emërllahu, ka konfirmuar për “Telegrafi”-n se lëndimi i tij i pësuar së fundmi është i lehtë dhe nuk do të mungojë asnjë ditë. Emërllahu u lëndua të hënën gjatë fitores 2-0 të ekipit të tij ndaj

Universitatea Craiova në raundin e tretë të “play-off”-it. Therandasi u detyrua ta lëshojë fushën në minutën e 73-të dhe presidenti i klubit, Cristian Balaj, ka thënë pas ndeshjes se ai ka pësuar një dëmtim të rëndë. Megjithatë, të martën Emërllahu ka treguar për

“Telegrafi”-n se, pas ekzaminimeve, u mësua se lëndimi është i lehtë dhe ai nuk do të mungojë fare, por do t'i bashkohet menjëherë ekipit në stërvitje. “Jo, pas ekzaminimit e kuptuam se është një lëndim i lehtë. Nuk do të mungoj asnjë ditë”, ka thënë Emërllahu. Vlen të

theksohet se Emërllahu kaloi te klubi rumun në afatin kalimtar të janarit nga Ballkani për 700 mijë euro, teksa shpejt fitoi një vend titullari. Që nga transferimi te Cluji, therandasi ka zhvilluar tetë ndeshje, e në dy të fundit luajti që nga minuta e parë.



Miami siguron fazën 'play-out', betejë e fortë në Perëndim

MIAMI, 8 MARS - Miami fitoi me rezultat 117-105 ndaj Philadelphia dhe rikthehet te suksesi në NBA, duke siguruar edhe kualifikimin në "play-out". Vendimtar stoli i Miamit, nga erdhën 46 pikë, ndërsa 58 pikët e dysjes Walker-Grimes për

miqtë mbetën për statistikë. Pa probleme fitoi edhe skuadra e Sacramento, që mundi me rezultat 127-117 Detroitin jashtë fushës. Tjetër ndeshje e mirë e Zach LaVine, që realizoi 43 pikë për miqtë, mbështetur edhe

nga Sabonis me një "triple double" (19 pikë, 15 rebounde e 10 asistime). Ajo që bie në sy është se në Konferencën e Lindjes janë përcaktuar ekipet që avancojnë më tej. Ndërkohë që, zyrtarisht janë eliminuar nga gara për

titull Toronto, Brooklyn, Philadelphia, Charlotte dhe Washington. Më e fortë beteja në Perëndim, ku të eliminuara janë Portlandi, San Antonio, New Orleans e Utah Jazz. Beteja vazhdon për një vend direkt në fazën "play-off" dhe për një vend




në "play-out", ku luajnë ekipet e vendeve 7-10.

Buruk akuzon Mourinhon: Ma gërvishtti fytyrën me thonj

STAMBOLL, 8 PRILL - Okan Buruk, trajner i Galatasarayt, ka dhënë një intervistë në Turqi. Ai e ka akuzuar Jose Mourinhon për një veprim të dhunshëm pas përfundimit të derbit të Stambollit në çerekfinalët e Kupës së Turqisë. Pas vërshëllimës së fundit, portugezi i "shtrëngoi hundën" Burukut, i cili ra në fushë duke u ankuar për dhimbje. "Hollywood e pa", komentoi Mourinho për atë çast, ndërsa më tej ka thënë: "Pamjet flasin vetë".

Okan Buruk, në një deklaratë për televizionin TV100, ka deklaruar: "U godita. Disa thonë që rënia ime ishte e ekzagjeruar, por kam zgjedhur të hesht sepse nuk dua ta zgjas më këtë histori". Mourinho, ndërkohë, mori një pezullim prej tri ndeshjesh, por nuk do ta vuajë këtë dënim deri në sezonin e ardhshëm. Sipas rregullores së futbollit turk, pezullimet deri në tri ndeshje zbatohen vetëm në



kompeticionin përkatës – dhe meqë Fenerbahçe është eliminuar nga Kupa e Turqisë, ai do ta vuajë pezullimin në sezonin 2025/2026. Buruk me pas ka shtuar: "Asnjë nuk do ta priste një sulm fizik në atë çast. Nuk mendova as për mënyrën si rashë. Ai më gërvishtti fytyrën me thonj. Bëri

një lëvizje të dhunshme, që më dhembti. Nëse do të kisha reaguar ndryshe, ndoshta do të isha pezulluar për 10 ndeshje. Nuk ndiej nevojën të përgjigjem. Kundërshtarët mund të përballen brenda dhe jashtë fushës. Kjo është normale për mua, por e kuptoj qëllimin që nga fillimi i sezonit".

Publikohet orari i plotë i 'play-off'-it të Superligës në basketboll



PRISHTINË, 8 PRILL - Faza vendimtare e ProCredit Superligës fillon tani. "Play-off"-i i ProCredit Superligës së Kosovës pritet të dhurojë spektakël në tribuna dhe sfida të bukura në parket. Çdo ndeshje do të jetë më e rëndësishme se tjetra, ku gabimet nuk lejohen. Në gjysmëfinale janë kualifikuar Bashkimi dhe Trepça, derisa në çerekfinale do të përballen vendi i tretë me të gjashtin, Sigal Prishtina - Vëllaznimi dhe i katërti me të pestin, Golden Eagle Ylli - Peja. Skuadra që shënon dy fitore kualifikohet në gjysmëfinale, derisa më pas skuadra që shënon tri fitore kalon në finale. Për ta fituar titullin duhen katër fitore.

ORARI I "PLAY-OFF" - PROCREDIT SUPERLIGËS

CEREKFINALET I		GJYSMËFINALET IV	
9 Prill	Sigal Prishtina-Vëllaznimi	30 Prill	1 Maj
10 Prill	Golden Eagle Ylli-Peja	GJYSMËFINALET V	
CEREKFINALET II		3 Maj	4 Maj
12 Prill	Vëllaznimi-Sigal Prishtina	FINALJA I	
13 Prill	Peja-Golden Eagle Ylli	7 maj	FINALJA II
CEREKFINALET III		11 maj	FINALJA III
16 Prill	3-6	14 maj	FINALJA IV
17 Prill	4-5	14 maj	FINALJA V
GJYSMËFINALET I		21 maj	FINALJA VI
19 Prill	20 Prill	25 maj	FINALJA VII
GJYSMËFINALET II		28 maj	
23 Prill	24 Prill		
GJYSMËFINALET III			
26 Prill	27 Prill		

SHKURT

Drejtori i Ferrarit: Do të sjellim risi për të kaluar këtë çast krize

Një tjetër garë zhgënjyese për Ferrarim, që në Japoni u rendit në vendin e katërt me Charles Leclerc dhe në atë të shtatë me Lewis Hamiltonin, rezultate që janë shumë larg me pritshmëritë që "kokëkuqja" kishte në fillim të sezonit. "Fotografia e garës së fundit tregon qartë realitetin tonë. Duhet të punojmë shumë, duke u nisur nga rezultati i garës së fundit", ka thënë drejtori i Ferrarit, Frederic Vasseur, në prag të garës së ardhshme të Formulës 1, këtë fundjavë në Bahrein. "Përditësimet do të vijnë së shpejti, por përpara se t'i sjellim dhe ta rrisim nivelin e performancës, ne duhet t'i rregullojmë problemet e balancimit në makinë. Pasi ta kemi zgjidhur këtë, do të ketë kuptim të bëjmë një hap përpara", ka shtuar Vasseur. Më tej, ai ka thënë: "Do të sjellim disa risi, por të mos presim që gjithçka të kthehet përmbyb brenda një dite. Ne po mundohemi ta shfrytëzojmë maksimumin nga kjo makinë sepse kemi ende potencial për të nxjerrë. Kjo do të jetë sfida e dy garave të ardhshme".

Guardiola: Tifozët e Unitedit duhet të ndihen të turpëruar për fyerjet ndaj nënës së Fodenit

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka dënuar ashpër sjelljen e disa tifozëve të Manchester Unitedit pas përfundimit të derbit të fundit. Bëhet fjalë për koret fyese të drejtuara ndaj nënës së Phil Foden nga tribuna e tifozëve të "Djajve të Kuq" ("Phil Foden, nëna jote është një lavire"): "Ka qenë një mungesë totale klasi, por nuk është Manchester Unitedi që njolloset si klub në këtë rast. Është çështje njerëzish. Ne, personat që jemi të ekspozuar në ekran, në botën e futbollit, veçanërisht trajnerët, pronarët dhe lojtarët, përballemi me gjëra të tilla. Singërisht, nuk e kuptoj çfarë kanë në mendje këta njerëz dhe ç'lidhje ka nëna e Phil me gjithçka. Është mungesë integriteti, mungesë klasi. Duhet të ndihen të turpëruar".

Ronaldinho: Më pëlqen Dembele, ka stil brazilian

Legjenda braziliane Ronaldinho, i njohur ndryshe si "El Gaucho", në një intervistë për "L'Equipe", ka folur rreth formës aktuale të Paris Saint-Germainit dhe lojtarëve që i kanë lënë përshtypje te këtë sezon të garave, sidomos Ousmane Dembele. "Nuk më pëlqen shumë të bëj krahasime", u shpreh fillimisht Ronaldinho. "I shikoj kryesisht skuadrat e mia të mëparshme, veçanërisht ato që ende janë në garë në Ligën e Kampioneve. Ousmane Dembele në PSG... më pëlqen shumë (qesh), ai ka një stil disi brazilian. Është i paparashikueshëm, krijues, provokues. Shpesh është i palexueshëm dhe, për më tepër, këtë sezon po luan një rol ndryshe – po shënon shumë gola", ka deklaruar ish-futbollisti i Brazilit. Ronaldinho ka qenë pjesë e PSG-së në vitet 2001-2003, para se të shkëlqente te Barcelona dhe të linte një trashëgimi të jashtëzakonshme në futbollin botëror.

Bayerni merr vendimin përfundimtar për të ardhmen e Leroy Sane

Bayern Munchen ka marrë një vendim të rëndësishëm për të ardhmen e Leroy Sanes pasi Arsenali mbajti bisedime me kampin e lojtarit. Sane, i cili është në muajt e fundit të kontratës në "Allianz Arena",

ka tërhequr interesim nga Arsenali i cili po synon transferimin e disa lojtarëve të rinj në verë për ta përforcuar sulmin. Sipas gazetarit Florian Plettenberg, Bayerni pritet t'i ofrojë një

kontratë të re reprezentuesit gjerman. Gazetari tutje shton se bordi i Bayernit e ka aprovuar rinovimin e kontratës së Sanes dhe drejtori sportiv Max Eberl do t'i paraqesë lojtarit një

kontratë të re e cila do të jetë e vlefshme deri në vitin 2028. Sulmuesi është i etur për të vazhduar me "bavarezët". Sane pati një fillim të vështirë të sezonit 2024/2025, por ai tashmë e ka fituar formën që

nga dhjetori i vitit të kaluar. Në pjesën e dytë të sezonit ai ka realizuar tetë gola në Bundesliga dhe ka luajtur rol të rëndësishëm që klubi i tij ta mbajë një distancë me Bayer Leverkusenin.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Doli” SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812041961 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Doli” D.O.O. Gjakovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812041961 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Doli” L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 812041961 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “T.D.A.P.” SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811125881 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “T.D.A.P.” D.O.O. Gjakovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811125881 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “T.D.A.P.” L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 811125881 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Besa Logistic” SH.P.K. me seli në Gji lanë, pronar Argton Ramadani dhe Afrim Agushi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811186867 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Besa Logistic” D.O.O. Gji lanë, Argton Ramadani, Afrim Agushi donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811186867 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Besa Logistic” L.L.C. with headquarters Gji lanë, Argton Ramadani dhe Afrim Agushi has come to the decision to quit its business: 811186867 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Blerton Thaqi nga Demjani i Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 1-5 dhe 6-9, të shkollës SHFMU “Shaban Gola”, Lipovec - Gjakovë.

Eugen Morina B.I nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër UNIK: 811967069.

- Sellmedin Bazda shpall të humbur certifikatën e biznesit “Nafo Dekor” me nr. 811565491.

- Sellmedin Bazda shpall të humbur certifikatën e biznesit “Nafo Dekor” me nr. 811565491.

- Beqir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesat nga kl. I-VIII të shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazrek Has Prizren.

- Hevzi Latifi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës profesionale “Ymer Prizreni” Prizren.

- Hajrush Gashi shpall të pa vlefshme dëftesën e klasës 1 deri 9 të shkollës fillore “Bajram Curri” në Kurushë të Madhe.

- Demokrat Rizanaj shpall të pa vlefshme diplomën e shkollës së mesme “Gani Çavderbasha” në Prizren.

- Dila Sopjani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Zef Lushmarku" Fshati Vilezh.
- Arbër Lipoveci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Naim J Gashi, B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr. 811147463 të lëshuar nga ARBK.

- Dulë Gjurarj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II të sh.f.m.u. “Shaban Gola” Lipavec KK Gjakovë.

- Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe –6-9

- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë. Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimanzit “Hajdar Dushi” Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

